



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

**VENDIM**  
**Nr. 88, datë 12.03.2021**

**PËR**  
**PROPOZIMIN PËR EMËRIM NË GJYKATËN E LARTË,**  
**TË KANDIDATIT {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, mbështetur në pikën 1, të nenit 136, në nenin 147 dhe në shkronjën “c”, pika 1, të nenit 147/a, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, pikën 2, të nenit 85 dhe në shkronjën “ë”, të nenit 86, të Ligjit nr.115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, në pikën 11, të nenit 48, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe në Kreun IX, të Vendimit të tij nr.70, datë 07.02.2020, “Mbi kriteret dhe procedurat e ngritjes në detyrë të gjyqtarëve”, në përfundim të procedurës së ngritjes në detyrë/emërimit në Gjykatën e Lartë, në pozicionin e lirë në fushën e të drejtës penale, të shpallur me Vendimin e tij nr. 241, datë 09.07.2020, mbi propozimin e relatorit të procedurës së përzgjedhjes së kandidatëve,

**VENDOSI:**

1. T’i propozojë Presidentit të Republikës emërimin në Gjykatën e Lartë, nga radhët e gjyqtarëve, të kandidatit {...}.
2. Një kopje e vendimit i njoftohet kandidatit {...}, sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

**PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**